

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "CAPITAL REAL ESTATE" Sh.p.k.**

Sot, më datë 25/04/2023,

- **Z. Salih TAGANI**, shtetas shqiptar, lindur më 18.07.1972, në Tiranë, mbajtës i dokumentit me nr. personal H20718103M, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Zj. Lisana TAGANI**, shtetase shqiptare, lindur më 29.07.1977, në Shkodër, mbajtëse e dokumentit me nr. personal H75729124M, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "CAPITAL REAL ESTATE" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "CAPITAL REAL ESTATE" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Dritan Hoxha", Vila nr.10, Tiranë. Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Agjenci imobiliare. Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate te veçante Franchising;
- Aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme;
- Aktivitet ne fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shitje me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie; hapje dyqanesh, degë apo zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë;
- Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Administrimin e bashkëpronësisë në prona dhe ndërtesa. Dhënien me qira dhe nën qira të ambienteve të ndryshme;
- Aktivitet në fushën e projektimit të godinave civile, mirëmbajtje dhe restaurim të objekteve të ndryshëm;
- Organizimi i eventeve, panairove, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjetër artistik dhe televiziv të çdo forme;

- Investime ne fushën e ndërtimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit të pasurive te pa luajtshme;
- Transportim mallrash, shërbime te ndryshme te lidhura me këtë aktivitet.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë) dhe është i përbërë nga 2 (dy) kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Salih TAGANI**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lekë (pesëdhjetë mijë lekë) dhe 50.000 Lekë (pesëdhjetë mijë lekë) të kapitalit themeltar.
- **Zj. Lisana TAGANI**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lekë (pesëdhjetë mijë lekë) dhe 50.000 Lekë (pesëdhjetë mijë lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Z. Salih TAGANI**, shtetas shqiptar, lindur me 18.07.1972, ne Tirane, mbajtes i dokumentit me nr. personal H20718103M, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

**NENI 7**

**LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 8**


**DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Salih TAGANI** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKET THEMELUES**

**SALIH TAGANI**

Handwritten signature of Salih Tagani in blue ink, written over a horizontal line.

**LISANA TAGANI**

Handwritten signature of Lisana Tagani in blue ink, written over a horizontal line.